



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/AJBINETI PRËDSIEDIJA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)


Nr./Br./No 06 Nr. i faq./Br.str./No.pg 95

Data/Datum/Date 5 / 1 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL
DHJETOR 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM	12

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2022.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji dhjetor i vitit 2022, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve të kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin dhjetor, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



I shoqëruar nga drejtori i DKRS - së, z. Afrim Dina, Kryetari Latifi priti në takim kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Agim Ademi dhe drejtuesit e "KF Rahoveci", me të cilët u pajtuan që në stadiumin "Jahja Danuza", të bëhen disa intervenime emergjente. Me z. Ademi u morëm vesh edhe për projekte të përbashkëta që do të realizohen shpejtë dhe klubeve tona do t'u ofrohet mundësi më e mirë e zhvillimit të garave në ligat në të cilat garojnë. Në fund, kryetari e faalenderoi kryetarin Ademi për vizitën dhe për gatishmërinë për investime të përbashkëta në infrastrukturën sportive në komunën e Rahovecit.

Në nderim të rënies së dëshmorëve Muhamet Malsori, Hysni Duraku dhe studentët-dëshmorë, Hida, Ismet, Isak, Sedat e Sinan Hoti nga Krusha e Madhe, së bashku me Skender Hamelin nga Mazreku i Hasit, të rënë në dhjetor të vitit të '98 në bjeshkën e Pashtrikut, kryetari së bashku me bashkëpunëtorët e tij, në prani të pjesëtarëve të OVL-UÇK-së dhe qytetarëve, bëri homazhe, ku u shpreh se rënia e tyre përbën një nga ngjarjet më tragjike e heroike njëkohësisht.



Kryetari Latifi së bashku me nënkryetarin z. Fatmir Iska, kanë marrë pjesë në fillimin e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve në fushën e stadiumit aktual të qytetit të Rahovecit, "JAHJA DANUZA", në mënyrë që të sigurohet se në sezonin pranveror në këtë fushë do të mund të zhvillohen ndeshjet futbolistike.

Së bashku me shefin e kabinetit Ali Morinën, si dhe me drejtorët Erhan Morinën dhe Albnor Mullabazin, kryetari takoi ministren e Ministrisë së Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli, ku patëm rastin për të diskutuar bashkëpunimin ndërmjet ministrisë dhe komunës, rreth projektit për vendosjen e paneleve diellore (solare) për prodhimin e energjisë elektrike, përmes ankandit publik, i cili do të jetë i pari i kësaj natyre në Republikën e Kosovës. Projekti i planifikuar do të zbatohet nga investitorë potencialë që parashihet të kontraktohen nga ana e ministrisë dhe kap vlerën rreth 100 milionë euro, ku parashihet të shtrihet në zonën kadastrale Kramovik dhe Guri i Kuq, me kapacitet prej 100 MW dhe në hapësirën prej 117 ha do të instalohen 258,068 panele diellore.



Drejtorja për Punë Inspektuese pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore, ka bërë rrënimin e dy objekteve të cilat kishin filluar të ndërtohen pa leje të organit kompetent komunal, saktësisht Drejtorisë së Urbanizmit. Drejtorja për Punë Inspektuese me këtë rast iu bënë thirrje të gjithë qytetarëve të Komunës së Rahovecit që të përmbahen dhe të mos fillojnë asnjë lloj pune në fushën e ndërtimit pa u pajisur paraprakisht me leje të ndërtimit, në të kundërtën, ndryshe nga vullneti dhe qasja aktuale e qeverisjes së Komunës, jemi të detyruar të ndërmarrim masa të ngjashme rrënimi, të rënda e të kushtueshme për të gjithë.

Kryetari Latifi, në shoqërimin e Drejtorit të Arsimit dhe stafit të DKA-së, takoi drejtorët e shkollave dhe këshillat drejtues. Të pranishëm ishin edhe pjesëtarë nga Stacioni Policor i Rahovecit si bartës të sigurisë dhe qetësisë publike.

Temë diskutimi ishte mbarëvajtja e procesit mësimor dhe sigurisë së përgjithshme në shkolla, si dhe u theksua se ndaj shkelësve të ligjit do të ndërmerren masa të nevojshme administrative për mosrespektimin e rregullave.




Në kuadër të shënimit të Ditës së Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", Zyra e Kryetarit të Komunës dhe DKRS, organizuan një manifestim kulturor, në kuadër të të cilit u mbajt edhe tryeza me temë "Roli dhe ndikimi i Sulejman Krasniqit në Lëvizjen ilegale shqiptare". Bashkëpunëtorët, të njohurit dhe artdashësit lexuan kumtesat e tyre shkencore bazuar mbi jetën dhe veprimtarinë letrare e historike të Sulejman Krasniqit. Me kumtesa u paraqitën; veprimtari Mehmet Hajrizi, Prof. Dr. Ermelinda Kashahu studiuese nga Gjirokastra, Prof. Dr. Sabahajdin Cena, Prof. Dr. Kudusi Lama, Dr. Shyqri Galica kryetari LSSHK, Fitore Rexhep Mala e Albana Sulejman Krasniqi. Po ashtu, u nda edhe Çmimi letrar "Sulejman Krasniqi" të cilin e ndan Komuna e Rahovecit. Këtë vit me propozim të kryetarit, Kuvendi Komunal ka bërë plotësim-

ndryshimin e tij duke i ndarë tre (3) çmime bazuar në konkursin e shpallur javë më parë. Juria profesionale e konkursit letrar "Sulejman Krasniqi" në përbërje prej: Prof. Dr. Besim Muhadri, Leonita Parallangaj, magjistre e letërsisë dhe Sokol Gashi, profesor i Gjuhës dhe i Letërsisë, shpallën tre fituesit e këtij konkursi. Vendi i tretë iu nda poezisë "Dilemë" me shifrën "Dora D'Istria".

Në vendin e dytë u rendit tregimi me titull "Berberi" me shifrën "Artemisa 2022".

Ndërsa vendi i parë iu nda poezisë me titull "Për token time" me shifrën "Dallëndyshja me fole Kosovë".

Nën kryesimin e kryetarit Smajl Latifi, është mbajtur mbledhja e 7 e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në të cilën mbledhje kryetari theksoi se situata e përgjithshme në komunën e Rahovecit është stabile, e qetë dhe pa ndonjë ndryshim të theksuar. Komandanti i stacionit policor në Rahovec, z. Fazli Morina foli si zakonisht rreth situatës së sigurisë në komunën tonë, i cili tha se raste nga vepra penale janë 36, incidente jopenale janë 2 dhe vjedhje të rënda janë 6 raste. Fatmirësisht dhuna në familje është në rënie theksoi ai. Sa i përket rastit që ka ndodhur në Hoçë të Madhe, pjesa zyrtare është veprë Sulm ndaj personit zyrtar, gjatë kryerjes së punës zyrtare. Ka ndodhur sekuestrimi i mallit i cili ishte i padoguanuar (prodhimi i verës). Sa i përket sigurisë në komunikacion janë shqiptuar 567 gjopa të trafikut, 129 për parkingje jo të rregullta, gjithashtu 5 kundërvajtje për prishjen e rendit dhe qetësisë publike.



Si pikë e rëndësishme e rendit të ditës ishte edhe Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2023, ku u aprovuan edhe dy pika tjera me propozim të Skender Hamzës:

- Mbrotjja e lumenjëve që rrjedhin;
- Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;



Rahoveci do të jetë Komuna e parë në Kosovë që do ta ketë emrin "Smart City" me anë të projektit që do të zbatohet nga shërbimet e energjisë (ESCO) nga investitori sloven. Ky projekt është në funksion të digjitalizimit të shërbimeve, do të ketë shtrirje në infrastrukturën ekzistuese të ndriçimit publik dhe në vendbanimet në të cilat kemi planifikuar ta zgjerojmë ndriçimin publik. Përfitimet nga ky projekt do të jenë kryesisht në kursimet e energjisë elektrike, të cilat do të arrijnë deri në 2000 MWh/vit (MegaVat Orë për një vit). Me ndihmën e këtij projekti, shërbimet digjitale të dedikuara për qytetarët e komunës së Rahovecit do të kenë karakteristikat si në vazhdim: Ndriçimi inteligjent: LED, kontrolli i fotocelulës, errësimi 0-100%, ndriçimi sipas kërkesës; Bazuar në APP: kontroll me

valë; Wi-Fi: celular dhe rrjetë; Altoparlantët e fshehur: muzikë, sinjalizime, Sensimi i imazhit: afërsia, sporteli i këmbësorëve, monitorimi i parkimit, siguria publike; Sinjalistika digjitale: gjetja e rrugës, drejtimi i trafikut, informacioni për qytetarë, potenciali i të ardhurave, shenja digjitale e rrugës. Sistemi Push-to-Talk: Shërbimet e 'dritës blu', karikimi(rimbushja)EV/ biçikleta elektronike, monitorimi i nivelit të ujit dhe përmytjeve, Ndjeshmëria mjedisore: cilësia e ajrit, zhurma, njoftimi RGBA.

I shoqëruar nga drejtori i DEZHT, z. Erhan Morina, zhvilluam takimin e parë këshillues me 28 përfaqësues nga komuniteti i biznesit për themelimin e Këshillit Publiko - Privat, të inicuar nga USAID si njëri prej aktiviteteve të rëndësishme që USAID - Qeverisja e Pronës, në bashkëpunim dhe partneritet me komunën e Rahovecit, si pjesë e projektit për qeverisje të mirë të pronës. Ky këshill do të ketë karakter këshilldhënës, do të mbajë takime të rregullta me qëllim të paraqitjes së kërkesave dhe harmonizimit të tyre, artikullimit dhe përkrahjes së sektorit privat, duke shfrytëzuar kornizën ligjore, në mënyrë që sektori privat përmes dialogut të vazhdueshëm me sektorin publik, të krijojë mundësi dhe lehtësira që potenciali ynë dhe resurset tona të përdoren për përparimin e zhvillimit ekonomik lokal.



Pas asistimit profesional në të gjitha fazat dhe procedurat ligjore deri te hapja e konkursit ndërkombëtar të projektimit, ku kanë aplikuar 80 studio të arkitekturës nga 37 vende të botës e të 5 kontinenteve, juria profesionale me tre anëtarë ndërkombëtarë e dy vendorë, me unanimitet ka vendosur për projektin e hartuar nga arkitektët: Thomas Boerendonk nga Holanda, Daniel Arce Chu nga Uruguaji dhe Nguyen Duy Minh nga Vietnami, të cilët i kanë dhënë Rahovecit një dizajn ikonik dhe shumëfunksional, ashtu siç e kërkuan qytetarët e komunës sonë. Përmes këtij projekti, synojmë që të kemi qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, e në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta. Disa të dhëna se çka parashihet në Sheshin Qendror të Rahovecit:

- Projekti do të pozicionohet aty ku takohen

shtegu i këmbësorëve dhe shëtitorja e gjelbër që ka edhe shtegun për biçiklistë dhe lidh veriun dhe jugun e qytetit me qendrën;

- Qendra e sheshit është në formë rrethore, e përshtatshme për ngjarje të mëdha dhe ofron hapësirë të mjaftueshme për funksione ditore;
- Ndërtimi i Qendrës së Komunitetit në lokacionin e Tregut ekzistues që do ta ndajë sheshin e vogël të "Hardhia" me Sheshin Qendror;
- Tregu ditor (i mbyllur);
- Parkingu nëntokësor dhe mbitokësor;
- Zhvendosja e stadiumit të qytetit dhe mbyllja e rr. Bajram Veliu që ndodhet anash stadiumit;
- Ndërtimi i një rruge të re të parkingut ekzistues që lidh rr. Xhelal Hajda - Toni dhe Ibrahim Rugova;
- Hapësira të reja gjelbëruese etj.

Kryetari Latifi priti në takim 8 përfitues, përpunues të pemëve dhe perimeve që i ka përkrahur (subvencionuar) nga thirrja e fundit e lëshuar nga drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në vlerë prej 28 mijë euro nga Komuna jonë. Përkrahja për përpunuesit e pemëve dhe perimeve do të jetë prioritet i yni edhe viteve në vazhdim. Ndërkohë, do të vazhdojmë përkrahjen konkrete edhe në fushëveprimtari të tjera ekonomike, si: zejtarët dhe artizanalet, bizneset e reja si dhe bizneset e vogla dhe të mesme, me qëllim të fuqizimit të tyre.



Në praninë e një numri të madh të qytetarëve, shoqërisë civile, kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, si dhe palëve të tjera të interesuara, kryetari Latifi ka paraqitur:

- Raportin e punës për vitin 2022;
- Planin e punës për vitin 2023;
- Listën e aktiviteteve të evidentuara gjatë këtij viti.
- Raportet e aktiviteteve thelbësore të secilës drejtori veç e veç - Ecuria e angazhimeve, investimeve, sukseseve dhe ngecjeve;
- Sfidat, detyrimet dhe përgjegjësitë dhe gjithë atë që ka ndodhur gjatë vitit 2022.

Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e DEZHT-së, Erhan Morina si dhe stafin e tij, morën pjesë në vënien e gurthemelit, të stacioni i autobusëve në Rahovec, aty ku do të bëhet ndërtimi i lokaleve afariste zejtare, i cili projekt arrin vlerën prej 84,879.12 €.





Në prani të shumë qytetarëve, kryetari ka përruruar Çerdhen për Fëmijë në Xërxë, projekt ky i cili është realizuar me buxhetin e komunës sonë. Çerdhja për fëmijë në Xërxë, e ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore tashmë është e gatshme me kushte shumë të mira infrastrukturore, mirëpo jemi në pritje të pajisjes me inventar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në çerdhe mund të sistemohen deri në 80 fëmijë, nga mosha 9 muajsh deri në 5 vjeç.

Së bashku me nënkryetarin, z. Fatmir Iska, drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale znj. Saranda Sallteku e me bashkëpunëtorët e tij, kryetari mbajti takimin e katërt me radhë gjatë këtij viti, me punëtorët shëndetësorë. Në takim u diskutua për të arriturat si dhe për sfidat e sistemit shëndetësor në komunën tone.



Në vigjilje të festave të fundvitit, në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj", u shfaq drama "KLITHMAT E TË PAFAJSHMËVE" me regji të regjisorit Gjergj Mena.

Në sallën e Kuvendit Komunal, nën shoqërimin e nënkryetarit Iska, të drejtorit të administratës Besnik Hotit dhe drejtorëve të drejtorive komunale, kryetari mbajti takimin e katërt të rregullt periodik me punonjësit e administratës komunale, të cilët i falenderoi për angazhimet dhe bashkëpunimin në baza ditore në përputhje me detyrimet e parapara me ligj, si dhe theksoi edhe një herë rëndësinë e respektimit të orarit të punës dhe punonjësit të kenë përkushtim të pazezervë në kryerjen e shërbimeve për qytetarë, duke ngritur gjithnjë e më shumë cilësinë e punës, për t'i bërë sa më të lehta dhe efikase shërbimet administrative.






Kryetari Latifi, i shoqëruar nga nënkryetari z. Fatmir Iska dhe drejtoresha e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale, znj. Saranda Salltëku, ka mbajtur takim me drejtorin e Qendrës për Punë Sociale, z. Ymret Reshiti dhe punëtorët e kësaj qendreje, e cila është kompetente për të ofruar shërbime profesionale dhe të veçanta si dhe për kujdesin ndaj qytetarëve me nevoja sociale.

Në bashkëpunim mes Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Komunës së Rahovecit, në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Gëzim Hamza-Piktori" solemnisht është hapur Qendra Arsimore për Komunitete me bazë në Shkollë". Vlera totale e këtij projekti me bashkëfinancim ka shumë më 20.357,00 €, ndërsa kontributi i komunës së Rahovecit është në vlerë prej 6.740,00 €. Qendra Arsimore është pajisur me inventar dhe pajisje të tjera mbështetëse, siç vijon: 40 karrige për nxënës; 20 banka shkollore; 2 Tabela (White Boards); 1 video projektor; 15 laptopë; 15 tabletë; 2 printerë; Pajisje laboratorike për fizikë; Pajisje laboratorike për kimi, si dhe pajisje të tjera.



Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij priti në takim punë Shëfinit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport, me të cilin biseduam lidhur me çështjet me interes të përbashkët si dhe format e vazhdimit të bashkëpunimit në mes të komunës së Rahovecit dhe misionit të OSBE-së në Kosovë.

Kryetari Latifi, së bashku me ministrin e MAPL-së, z. Elbert Krasniqi, përruan projektin e bashkëfinancuar nga MAPL dhe Komuna e Rahovecit, me anë të të cilit janë zgjeruar dhe rregulluar me kubëza tri rrugë dhe një kënd rekreativ. Emri i projektit është "Ndërtimi i rrugëve dhe këndit rekreativ në lagjen e komuniteteve". Realizimi i këtij projekti ka kushtuar gjithsej 61.000€, ku nga kjo shumë MAPL ka financuar 40.000 €.



Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e AMKMK, z. Bislim Zogaj, e në prani të familjarëve, miqve e bashkëlufëtërëve, përruan Memorialin e Dëshmorëve dhe Martirëve në fshatin Retijë. Projekti u finalizua në bashkëfinancim me Agjencionin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, me vlerë 12.326 €.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, edhe këtë vit organizoi ceremoninë e zgjedhjes së laureatëve të sportit për vitin 2022 në komunën tonë.

Sportistët që spikatën me rezultate të lakmueshme gjatë këtij viti, ishin:

Sportistja me prespektivë – Elma Sharku;

Sportisti me prespektivë – Sinan Kadiri;

Klubi i vitit 2022 – KH "Rahoveci";

Trajneri i vitit 2022 – Xhafer Bytyqi;

Gjyqtari i vitit 2022 – Taulant Haxhimustafa;

Punëtori sportiv i vitit – Burim Dula

Veteran aktiv i sportit gjatë vitit 2022 – Bekim Cena;

Veteran sportiv i vitit 2022 – Sadedin Cena dhe

Sportisti i vitit 2022 u zgjodh– Kenan Haxhihamza.



Ka filluar puna në instalimin e ndriçimit publik në Vrajkë dhe Bratotin. Ndriçimi publik që do të instalohet është ndriçim smart me shërbimet ESCO, të cilat përmbajnë në vete edhe efektet e kursimit të energjisë. Pas përfundimit të këtyre dy vendbanimeve, do të vazhdojnë punimet edhe në vendbanimet tjera, të cilat aktualisht nuk kanë ndriçim publik.

Mirënjohje dhe respekt të veçantë për mërgimtarin Agron Berisha, i cili vite me radhë po ndihmon me donacionet e tij të njëpasnjëshme në Shkollën "Rudolf Walther" në Dejnë, shkollat tjera, e gjithashtu edhe QMF-në në Ratkoc me pajisje teknologjike. Agron Berisha ka pajisur fillimisht 10 klasa të shkollës me inventarë (banka e karrige për nxënës) e pastaj në muajin maj të këtij viti ka pajisur Shkollën "Rudolf Walther" në Dejnë dhe Dobidol me pajisje teknologjike në vlerë prej 8500€. Para pak ditësh ai erdhi sërish nga mërgimi duke sjellë me vete edhe shumë pajisje të tjera "Smart Televizorë, Laptopë, Videoprojektorë, Printerë, makinë kositëse të barit, etj, për këtë shkollë dhe për Shkollën "Rilindja" në Çifllak. Gjithashtu, ai ka sjellë pajisje edhe për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Ratkoc. Kontributi i deritanishëm i mërgimtarit tonë Agron Berisha kap vlerën mbi 30.000 €.



PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit dhjetor 2022.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini mujor ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparencja të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, dhjetor 2022